# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5909
E hënë, 21 tetor 2019
çmimi 0.40 €


## Dirks: Kosovës i nevojitet një burim stabil i gjenerimit të energjisë elektrike FAQE 9




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI FAQE 4-5

# Koalicioni Nisma-AKR-PD do ta kalojë pragun, AKR-ja do t'i ketë tre deputetë



Kryetari i Kuvendit të AKR-së, Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se rinumërimi i 530 kutive të votimit po dëshmon parregullsitë dhe dëmet që i janë bërë koalicionit Nisma-AKR-PD. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se pas korrigjimeve të këtyre gabimeve ky koalicion do ta kalojë pragun zgjedhor. Kandidati për deputet i këtij koalicioni ka treguar se pas kalimit të pragut AKR-ja do të përfaqësohet me tre deputetë në Kuvendin e Kosovës

## Rinumërohen 265 vendvotime nga 530 sa janë gjithsej FAQE 3

Në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) deri në pasditen e së dielës janë rinumëruar 265 vendvotime nga 530 sa janë gjithsej. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se procesi i rinumërimit është duke u vëzhguar nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Ai ka treguar se pas këtij rinumërimi do të fillojë numërimi i votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Sipas Elezit, pas kompletimit të këtij procesi KQZ-ja do të procedojë drejt shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit. Kurse certifikimi parashihet të bëhet



pas përfundimit të ankesave të mundshme në PZAP dhe në Gjykatën Supreme



## Mungesë të profesorëve dhe të cilësisë së kuadrove akademike FAQE 7

## OPINION

### IDETË E KUNDËRTA KOMBIT NUK I DUHEN PËR SHKATËRRIM, POR PËR ZHVILLIM F. 6

Jakup KRASNIQI



### BALLKANI MES PAQES DHE GJEOPOLITIZIMIT F. 6

Dr. Edita TAHIRI



## AKTUALE

### PËR NËNTË MUAJ POLICIA KA KONFISKUAR 892 ARMË PA LEJE F. 6

## EKONOMI

### BORXHI NDAJ 'TERMOKOS'-it, RRETH 15 MILIONË EURO F. 9

## KULTURË

### NJË MANUAL I RËNDËSISHËM PËR GAZETARINË DHE SHKENCAT POLITIKO-JURIDIKE F. 11

Lulëzim ETEMAJ



## SPORT

### DRITA FITON DERBI DHE MERR KREUN F. 18




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta në Japoni, merr pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Perandorit

**Tiranë, 20 tetor** - Me ftesë të Perandorit të Japonisë, presidenti i Shqipërisë Ilir Meta është nisur të dielën për në Tokio, për të marrë pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Madhërisë së Tij Perandorit të ri të Japonisë, Naruhito.
Gjatë qëndrimit të tij në Tokio, presidenti Meta do të pritet në një takim të veçantë nga kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, si dhe do të ketë takime me disa kryetarë të shteteve të ndryshme, pjesëmarrës në këtë ceremoni.
Japonia është një partner tepër i rëndësishëm i Shqipërisë, me kontribute të jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Shqipëria dhe shqiptarët janë shumë mirënjohës për solidaritetin, mbështetjen dhe ndihmat bujare teknike e financiare të dhëna ndër vite, që e kanë forcuar edhe më shumë ndjenjën e miqësisë së popullit shqiptar për Japoninë dhe popullin japonez.
Hapja e ambasadave në Tiranë dhe në Tokio, i ka dinamizuar dhe zhvilluar marrëdhëniet si kurrë më parë, duke rritur jo vetëm bashkëpunimin politik e ekonomik, por mbi të gjitha kontaktet e drejtpërdrejta midis dy vendeve tona.




# Shkupi pritet të vendosë për datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

Për kërkesën e kryeministrit, Zoran Zaev për zgjedhje të parakohshme, do të diskutohet në një takim të thirrur të dielën në mbrëmje nga presidenti, Stevo Pendarovski, në të cilin do të marrin pjesë të gjitha partitë të përfaqësuara me deputetë në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut




**Shkup, 20 tetor** - Liderët e partive politike në Maqedoninë e Veriut, të dielën është dashur të vendosin për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.
Për kërkesën e kryeministrit, Zoran Zaev, do të diskutohet në një takim të thirrur të dielën në mbrëmje nga presidenti, Stevo Pendarovski, në të cilin do të marrin pjesë të gjitha partitë të përfaqësuara me deputetë në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut.
Lidhja Social-Demokrate e kryeministrit, Zoran Zaev përmes një komunikate, ka përsëritur qëndrimin e kreut të saj se "Bashkimi Evropian ka bërë gabim historik në vendimin për mosdhënien e datës për fillimin e negociatave për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut".
Prandaj, LSDM-ja vlerëson nevojën "për zgjedhje të shpejta parlamentare për të vazhduar fuqishëm me rrugën e duhur për reforma, përparim dhe integrim...ëndrra evropiane e popullit maqedonas, shqiptar dhe të tjerëve që jetojnë në vend nuk do të prishet, prandaj nevojitet organizim i zgjedhjeve të shpejta parlamentare. Zgjedhje sa më shpejtë që të jetë e mundur", thuhet në një njoftim me shkrim të LSDM-së, ka njoftuar rfe.
Para takimit te presidenti Pendarovski, ka reaguar edhe opozita maqedonase, e cila në vazhdimësi kërkon zgjedhje të parakohshme ndërsa për mosmarrjen e datës së bisedimeve sërish ka akuzuar, qeverinë e kryeministrit, Zoran Zaev.
"Zoran Zaev i ka ditët e numëruara. Po shihet fundi i bandës kriminale në krye me të amnistuarin Zaev. Po perëndon koha e tenderëve dhe granteve kriminale zhvatëse, e presioneve politike, padrejtësive dhe mosndëshkimit të krimit. Po vjen koha kur politikanët nuk do të jenë sinonim i premtimeve të rreme dhe pritjeve të parealizueshme. Tani është koha për politikanë të ndershëm", thuhet në reagimin e VMRO-DPMNE-së.
Edhe partitë shqiptare në pushtet dhe opozitë janë shprehur për zgjedhje të parakohshme parlamentare.
"Bashkimi Demokratik për Integrim e gatshme për zgjedhje të parakohshme. Zgjedhjet janë zgjidhja më e mirë të zhvillimeve pas mos marrjes së datës për nisjen e bisedimeve... Këtu nuk do të doja që të ne të vendosemi në gjahtar të fajtorëve sepse është e papranueshme të pranosh një faj të pabërë. Maqedonia e Veriut është dëm kolateral i vetë dallimeve brenda Bashkimin Evropian", ka deklaruar kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti.
Aleanca për Shqiptarët në opozitë konsideron se kërkesa për zgjedhje të parakohshme është lajmi i mirë pas dështimit për marrjen e datës për çeljen e bisedimeve të anëtarësimit me BE-në.
"Votuesit shqiptarë do të kenë mundësinë për të dhënë një legjitimitet të ri politik pasi partitë në pushtet nuk kishin kredibilitetin e duhur për ta çuar vendin drejt integrimeve evropiane. Jemi të gatshëm për zgjedhje të bindur se do të jemi forca fituese, që do të hapë një perspektivë për qytetarët duke i dhënë fund politikës dy dekadëshe të BDI-së", ka deklaruar Flakron Bexheti nga Aleanca për Shqiptarët.
Sipas Ligjit për Qeverinë, 100 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve vendi duhet të ketë një qeveri teknike, me një kryeministër të ri ndërsa në të do të marrë pjesë edhe opozita e cila duhet të drejtojë dy ministri, atë të Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, si dhe dy poste tjera të zëvendësministrave.
Mbetet e paqartë gjithashtu se me çfarë rregullative zgjedhore do të mbahen zgjedhjet duke marrë parasysh faktin se partitë kanë qenë duke negociuar edhe për një Kod të ri zgjedhor për të përfshirë rekomandimet e OSBE- ODIHR-së, por edhe kërkesat për njësit zgjedhore dhe listat e hapura.

## Kurti takon Weller, bisedojnë për situatën në Kosovë

**Prishtinë, 20 tetor** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër të Kosovës, Albin Kurti ka bërë të ditur se ditë më parë gjatë vizitës në Londër është takuar me profesorin e njohur të Universitetit të Cambridge-it, Marc Weller me të cilin ka biseduar për situatën aktuale në Kosovë, Ballkan dhe të ardhmen në Evropë.
"Gjatë vizitës në Londër, takuam edhe profesorin e mirënjohur nga Universiteti Cambridge, Marc Weller, ekspert i të drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, si dhe i studimeve ndërkombëtare kushtetuese. Në Klubin e reformistëve ku dikur shkruanin e diskutonin jo vetëm politikanë e kryeministra por edhe shkrimtarë të famshëm prej H. G. Wells tek E. M. Forster, biseduam për situatën në Kosovë, raportet në Ballkan dhe të ardhmen e Evropës", ka shkruar Albin Kurti në Facebook.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Është duke vazhduar procesi i rinumërimit të 530 kutive të votimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

# Rinumërohen 265 vendvotime nga 530 sa janë gjithsej

**Në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) deri në pasditen e së dielës janë rinumëruar 265 vendvotime nga 530 sa janë gjithsej. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se procesi i rinumërimit është duke u vëzhguar nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Ai ka treguar se pas këtij rinumërimi do të fillojë numërimi i votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Sipas Elezit, pas kompletimit të këtij procesi KQZ-ja do të procedojë drejt shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit. Kurse certifikimi parashihet të bëhet pas përfundimit të ankesave të mundshme në PZAP dhe në Gjykatën Supreme**




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 TETOR - Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) edhe të dielën ka vazhduar rinumërimi i 530 vendvotimeve për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur t'i nënshtrohen procesit të rinumërimit për shkak të problemeve kryesisht teknike.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se deri në orën 16:00 të së dielës janë rinumëruar 265 vendvotime nga 530 sa janë gjithsej. Ai ka treguar se procesi i rinumërimit është duke u vëzhguar nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu, Elezi ka paralajmëruar se menjëherë pas përfundimit të rinumërimit që do të përfundojë brenda pak ditësh, do të fillojë procesi i numërimit të votave me kusht dhe të votave të personave me nevoja të veçanta. Vota me kusht pritet të jenë mbi 25 mijë, kurse vota të personave me nevoja të veçanta mbi dy mijë, ndonëse numri i tyre ende nuk është zyrtarizuar. "Deri në orën 16 të së dielës janë rinumëruar gjysma e vendvotimeve. Sipas të dhënave të pasdites, janë rinumëruar 265 vendvotime apo 50 % nga 530 sa janë planifikuar. Procesi i rinumërimit është duke u vëzhguar vazhdimisht nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Pas rinumërimit do ta fillojmë numërimin e votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta", ka deklaruar ai.

Sipas Elezit, pas kompletimit të këtij procesi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do të procedojë më tutje drejt shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit. Ai ka thënë se certifikimi parashihet të bëhet në një fazë tjetër, pasi të përfundojnë të gjitha çështjet dhe ankesat e mundshme që subjektet politike dhe kandidatët mund t'i parashtrojnë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa si dhe në Gjykatën Supreme për rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja. "KQZ-ja i shpall rezultatet përfundimtare të një procesi zgjedhor pas numërimit të votave me kusht, votave me postë, votave të personave me nevoja të veçanta dhe pas rinumërimeve eventuale të vendvotimeve për të cilat vendos KQZ-ja. Shpallja e rezultateve përfundimtare dhe pastaj certifikimi i tyre janë dy çaste të procesit zgjedhor që për të arritur deri aty ka procedura ligjore, prandaj duhen disa ditë", është shprehur Elezi.

Ai ka rikujtuar se edhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014 dhe të vitit 2017 KQZ-së i është dashur përafërsisht kohë e njëjtë për të shpallur, pastaj për ta certifikuar rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Elezi ka thënë se KQZ-ja po bën përpjekje maksimale për t'i arritur të paktën të njëjtat afate edhe për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit. "Në vitin 2014 nga dita e zgjedhjeve deri në certifikim të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve janë plot 27 ditë, kurse në vitin 2017 një ditë më shumë 28. KQZ-ja po bën përpjekje maksimale për t'o arritur të paktën të njëjtat afate", ka theksuar ai.

Ndërsa 530 vendvotimet të cilat iu kanë nënshtruar procesit të rinumërimit iu përkasin komunave të ndryshme të Republikës së Kosovës. Nga të gjeturat e auditimit rezulton se janë 149 vendvotime te të cilat nuk përputhen votat e kandidatëve me votat e subjekteve politike për shkak të gabimit teknik në formularin e rezultateve të subjekteve politike. Po sipas auditimit, rezulton se 24 vendvotime kanë probleme teknike të mospërputhjes së numrit të fletëvotimeve, mungesës së faqeve apo rezultatet janë të paqarta. Nga të gjeturat e auditimit rezulton se 81 vendvotime nuk kanë vota te subjekti politik, por vetëm te kandidati/kandidatët. Po ashtu, në 89 vendvotime është vërejtur se kandidati ka më shumë vota se subjekti politik, kurse në 187 vendvotime rezulton se kandidatët kanë më shumë vota se subjekti politik.



## Thaçi udhëton për Japoni, merr pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Perandorit Naruhito

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, është nisur të dielën për në Japoni, ku do të marrë pjesë në ceremoninë e kurorëzimit të Perandorit Naruhito, të martën, më 22 tetor.

Në ceremoninë zyrtare do të marrin pjesë 2 600 mysafirë nga e tërë bota, ndër ta edhe shumë burrështetas. Ceremonia zyrtare e kurorëzimit të Perandorit Naruhito bëhet gjashtë muaj pasi ka trashëguar fronin nga babai i vet, Perandori Akihito, i cili ka abdikuar në prill të këtij viti.

Presidenti Thaçi do të pritet në takim zyrtar edhe nga kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, ndërsa në ceremoninë zyrtare pritet të takojë edhe përfaqësues të tjerë të shteteve pjesëmarrëse.

Flet për "Epokën e re", Fatmir Matoshi

# Koalicioni Nisma-AKR-PD do ta kalojë p

Kryetari i Kuvendit të AKR-së, Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se rinumërimi i 530 kutive të votimit po dëshmon parregullsitë dhe dëmtimet që i janë bërë koalicionit Nisma-AKR-PD. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se pas korrigjimeve të këtyre gabimeve ky koalicion do ta kalojë pragun zgjedhor. Kandidati për deputet i këtij koalicioni ka treguar se pas kalimit të pragut AKR-ja do të përfaqësohet me tre deputetë në Kuvendin e Kosovës



EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtinë, 20 tetor - Kryetari i Kuvendit të AKR-së, Fatmir Matoshi, është shprehur i bindur se koalicioni Nisma-AKR-PD do ta kalojë pragun zgjedhor pas rinumërimit të 530 kutive të votimit. Ai ka thënë se procesi i rinumërimit ka evidentuar disa parregullsi, korrigjimi i të cilave do të sjellë rezultat pozitiv për këtë koalicion. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Matoshi ka vlerësuar se për këto manipulime dikush duhet të japë përgjegjësi. "Koalicioni ynë ka kërkuar që të ketë rinumërim të tërësishëm të votave. Kjo kërkesë nuk është aprovuar. Megjithatë, KQZ-ja ka marrë vendim për rinumërim të disa kutive në komuna të ndryshme. Gjatë këtij rinumërimi po vërehen dhe po raportohen shumë parregullsi dhe dëmtime që i janë bërë koalicionit tonë. Korrigjimi i tyre patjetër se do të sjellë një rezultat më pozitiv për koalicionin AKR-NISMA-PD", ka thënë Matoshi, i cili është kandidat për deputet nga ky koalicion.

Ai ka pranuar se koalicioni ka pritur rezultat më të mirë nga zgjedhjet e 6 tetorit. "Ne jemi të bindur se kemi qenë pjesë e Kuvendit edhe të dielën e 6 tetorit bazuar në votat që janë në kuti të votimeve. Pavarësisht se koalicioni ynë do të jetë në Kuvend, më duhet të theksoj se ky rezultat nuk ishte ai që prisnim ne si subjekte politike", ka deklaruar Matoshi, duke shtuar se procesi i rinumërimit po merr pak kohë, por po qartëson çdo gjë. "E kuptojmë që i tërë ky proces po merr kohë pak më shumë sesa që do të duhej, por e mira e këtij pune është që procesi i rinumërimit po përcillet në mënyrë strikte nga përfaqësues të të gjitha subjekteve politike, vëzhgues të huaj, prokurorë, hetues etj. E gjithë kjo është një shpresë më shumë për një proces të pastër zgjedhor dhe, po ashtu, masat që priten të merren ndaj keqpërdoruesve të vullnetit qytetar do të jenë shenjë e mirë për proceset e ardhshme zgjedhore", është shprehur Matoshi.

Matoshi ka folur edhe për numrin e deputetëve që AKR-ja do t'i ketë në Kuvend nëse ky

## Haziri: Arritja e unitetit politik për temat e mëdha, sfida kryesore e qeverisë së re

Prishtinë, 20 tetor (ER) - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka thënë se kjo parti në vazhdimësi ka qenë gardiane e demokracisë. Ai ka bërë me dije se sfida kryesore e qeverisë në ardhje është arritja e unitetit politik në Kuvendin e Republikës për temat e mëdha e me interes kombëtar. "LDK-ja ka qenë gjithmonë gardiane e këtij demokracie, sado fragjile që është. Të jeni të sigurt se ç'kapja e shtetit që është bërë si politikë populiste në Kosovë nuk do të lejohet të zëvendësohet me kapjen e re të shtetit. Sfida kryesore e qeverisë në ardhje është që të arrihet uniteti politik në Kuvendin e Republikës për temat e mëdha e me interes kombëtar. Nuk kemi komoditet që 11 vjet pas pavarësisë të jetojmë pa stabilitet!", ka shkruar Haziri në llogarinë e vet në "Facebook".



# ragun, AKR-ja do t'i ketë tre deputetë



koalicion e kalon pragun zgjedhor. Sipas tij, në organin më të lartë legjislativ kjo pati do t'i ketë tre deputetë. "Unë besoj se AKR-Nisma-PD e ka kaluar pragun e përcaktuar për përfaqësim në Kuvend. Në bazë të rezultateve që ne tani i kemi, presim që AKR-ja të përfaqësohet me tre deputetë në përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës", ka bërë me dije Matoshi.

**"Epoka e re":** *Z. Matoshi, deri më tani janë rinumëruar gati 50 për qind e kutive që ka kërkuar KQZ-ja. Në bazë të informatave që keni deri më tani, a është vërejtur ndonjë manipulim i votave të këtij koalicioni?*

**Matoshi:** Kosova ka kaluar një proces demokratik dhe të qetë zgjedhor. Të metat e këtij procesi janë hetuar në bartjen e të dhënave nëpër formular dhe, po ashtu, edhe në tjetërsim të rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve në subjekte e koalicione që garuan së bashku. Koalicioni ynë ka kërkuar që të ketë rinumërim të tërësishëm të votave. Kjo kërkesë nuk është aprovuar. Megjithatë, KQZ-ja ka marrë vendim për rinumërim të disa kutive në komuna të ndryshme. Gjatë këtij rinumërimi po vërehen dhe po raportohen shumë parregullsi dhe dëmtime që i janë bërë koalicionit tonë. Korrigjimi i tyre patjetër se do të sjellë një rezultat më pozitiv për koalicionin AKR-NISMA-PD.

**"Epoka e re":** *Sa besoni se më këtë rinumërim të votave koalicioni Nisma-AKR-PD do të bëhet pjesë e Kuvendit?*

**Matoshi:** Qytetarët kanë dhënë verdiktin e tyre më 6 tetor. Deformimet e bëra rezultatit pas orës 19.00 të ditës së zgjedhjeve duhet të korrigjohen dhe kjo po ndodh në Qendrën e Numrit dhe Rezultateve. Ne jemi të bindur se kemi qenë pjesë e Kuvendit edhe të dielën e 6 tetorit bazuar në votat që janë në kuti të votimeve. Pavarësisht se koalicioni ynë do të jetë në Kuvend, më duhet të theksoj se ky rezultat nuk ishte ai që prisnim ne si subjekte politike.

**"Epoka e re":** *Edhe kandidatët për deputetë të partive të tjera janë ankuar te komisionarët për manipulim të votave. A duhet të japë dikush përgjegjësi për këto lëshime?*

**Matoshi:** Patjetër se po, përgjegjësia për organizmin e zgjedhjeve është e KQZ-së. Zgjedhjet janë të kushtueshme, por ia vlen që në procesin zgjedhor të investohet edhe më tepër në mënyrë që të sigurohen edhe qytetarët, por edhe kandidatët se nuk do të mund të ketë deformim të rezultateve. Është shumë e rëndë nëse një kandidat i votuar për të qenë përfaqësues në Kuvend mbetet jashtë tij dhe ulësen e tij e merr një tjetër pa legjitimitet, por me manipulim votash. Ndoshta në zgjedhjet që vijnë duhen përdorur edhe skanerët ose ndonjë metodë më e avancuar që parandalon keqpërdorimet dhe tjetërsimin e vullnetit qytetar.

**"Epoka e re":** *Ky koalicion edhe më herët ka kërkuar rinumërim të votave në nivel vendi. A do ta bëni të njëjtën ankesë në PZAP pas përfundimit të procesit?*

**Matoshi:** Tashmë po rinumërohen një numër i madh i vendvotimeve. Mund të ketë edhe vendime të reja nga KQZ-ja për rinumërime. E kuptojmë se i tërë ky proces po merr kohë pak më shumë sesa që do të duhej, por e mira e kësaj pune është se procesi i rinumërimit po përcillet në mënyrë strikte nga përfaqësues të të gjitha subjekteve politike, vëzhgues të huaj, prokurorë, hetues etj. E gjithë kjo është një shpresë më shumë për një proces të pastër zgjedhor dhe, po ashtu, masat që priten të merren ndaj keqpërdoruesve të vullnetit qytetar do të jenë shenjë e mirë për proceset e ardhshme zgjedhore.

**"Epoka e re":** *Nëse ky koalicion e kalon pragun, sa deputetë mund t'i ketë AKR-ja në Kuvend?*

**Matoshi:** Unë besoj se AKR-Nisma-PD e kanë kaluar pragun e përcaktuar për përfaqësim në Kuvend. Në bazë të rezultateve që ne tani i kemi, presim që AKR-ja të përfaqësohet me tre deputetë në përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës.

## Kuçi thotë se, edhe po të ishte Hashim Thaçi në krye të PDK-së, vështirë se do të evitohej humbja në zgjedhje

**Prishtinë, 20 tetor** - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kandidati për deputet nga ky subjekt politik, Hajredin Kuçi, ka folur në emisionin "Personale" në RTV Dukagjini për zhvillimet politike pas zgjedhjeve të 6 tetorit. Kuçi ka thënë se PDK-ja në kohën e Hashim Thaçit ka qenë një lëvizje nacionale, ndërsa në kohën e Kadri Veselit është dashur të shndërrohet në një lëvizje politike me njerëz të ri.

Ai ka thënë se secila periudhë e PDK-së i ka specifikat e veta, por nuk mund të ndahen në epoka. "Veseli e ka ruajtur kohezionin e partisë. Kemi dallim me vendin e parë me rreth 30 mijë vota dhe me përkushtim më të madh do të dalim fitues. Edhe zoti Thaçi po të ishte në krye të PDK-së herën e pestë është më problem të ofrojë diçka tjetër. Natyrisht, pritjet e njerëzve, sidomos të të rinjve, janë shumë të mëdha. Më vjen keq ta them se pritjet e tyre janë më të mëdha se kapacitetet që ka Kosova".

Nënkryetari i PDK-së thotë se një pjesë e votuesve që tashmë janë nën 20 vjeç nuk e mbajnë në mend luftën dhe ata është vështirë të menaxhohen për shkak të zhvillimeve teknologjike.



## Shtetet e Quintit interesohen për procesin zgjedhor të 6 tetorit

**Prishtinë, 20 tetor (ER)** - Me ftesë të delegacioneve të shteteve të Quintit (ShBA-së, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë) dhe Austrisë me seli në Vjenë, kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka dhe ambasadori i misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan Braathu, i informuan pjesëmarrësit e shteteve anëtare të OSBE-së lidhur me procesin zgjedhor të 6 tetorit 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u përgëzua për administrim shumë të mirë të zgjedhjeve si dhe u konkludua se ky sukses i Kosovës për proceset zgjedhore është një shembull në rajon.

Kryetarja Daka ka falënderuar OSBE-në për përkrahjen e vazhdueshme si dhe shtetet e Quintit dhe Austrinë për përkrahjen dhe organizimin e këtij takimi.



Në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka përkujtuar ish-rektorin Ejup Statovci

# Kërkohet që një institucion i lartë arsimor, një shesh dhe një rrugë ta mbajnë emrin e ish-rektorit Ejup Statovci



Me rastin e 20-vjetorit të ndarjes nga jeta të ish-rektorit Ejup Statovci, Muhamet Mavraj, një ndër udhëheqësit e protestave studentore dhe ish-kryetar i Kuvendit të Unionit të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, ka kërkuar sërish, si para disa vjetësh, që një institucion i lartë arsimor, një shesh meritor dhe një rrugë ta mbajnë emrin e rektorit Ejup Statovci

**Prishtina, 20 tetor (ER)** - Jeta dhe vepra e ish-rektorit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Ejup Statovcit, është përkujtuar në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta nëpërmjet një ore përkujtimore të organizuar nga Parlamenti Studentor i UP-së. Duke e konsideruar si njërin ndër personalitetet më të rëndësishme të universitetit, prorektorja prof. dr. Myrvete Badivuku ka thënë se vepra e tij do të mbetet përherë e gjallë. "Figurat si profesor Statovci janë ato për të cilat historia ruan faqe të veçanta nderi për to. Për të gjithë ata që patën rastin ta njohin, profesor Statovci paraqiste figurën e një intelektuali, i cili jo vetëm që ndante dijen e vet për studentët, por ishte pranë atyre, universitetit dhe gjithë popullatës, duke u prirë ndryshimeve më të nevojshme dhe më pozitive që ndodhen në vendin tonë në kohët më të vështira", ka thënë Badivuku.




Punën e tij e ka përkujtuar edhe bashkëpunëtori i tij, dekani i Fakultetit Filozofik, prof. dr. Bujar Dugolli, i cili ka thënë se qasja që e pati aplikuar Statovci për ta kundërshtuar okupimin serb pati qenë qasje e re.

Me një fjalë rasti të pranishmëve u është paraqitur edhe prof. dr Abdulla Aliu, i cili ka theksuar se ish-rektori Statovci qe angazhuar gjithmonë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Ndërkaq Muhamet Mavraj, një ndër udhëheqësit e protestave studentore dhe ish-kryetar i Kuvendit të Unionit të Studentëve të Universitetit të Prishtinës, ka kërkuar sërish, si para disa vjetësh, që një institucion i lartë arsimor, një shesh meritor dhe një rrugë ta mbajnë emrin e Ejup Statovcit.

Punën e ish-rektorit Statovci e kanë vlerësuar lart edhe studentët, në emër të të cilëve ka folur kryetari i PS-së, Edon Nishori. Pas orës përkujtimore u bënë homazhe pranë varrit të ish-rektorit Statovci.

Prof. dr. Ejup Statovci ishte profesor në Fakultetin Juridik të UP-së dhe rektor i Universitetit të Prishtinës prej vitit 1991 e deri më 1997.

## PD-ja e shqetësuar me manipulimin e votave, thotë se u takon një deputet

**Prishtinë, 20 tetor (ER)** - Partia e Drejtësisë (PD) ka njoftuar se me vëmendje është duke e përcjell gjithë procesin e rinumërimit të votave. Ky subjekt politik ka shprehur shqetësimin rreth manipulimit të votave nga ana e komisionarëve. Sekretari i përgjithshëm i PD-së, njëherësh shef i shtabit, Eroll Venhari, ka deklaruar se PD-ja është e shqetësuar me manipulimin e votave dhe se pret që pas rinumërimit të jetë e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës me një deputet. "Sipas informatave që i kemi nga terreni, kemi afër 5 000 vota të kandidatit tonë për deputet. Ne i kemi mbledhur të gjitha deklaratat e atyre të cilët na kanë votuar dhe që votat e tyre nuk kanë dalë. Ne po presim të përfundojë procesi i rinumërimit dhe t'i deponojmë ankesat tona në PZAP brenda afateve ligjore", ka thënë Venhari.



# Mungesë të profesorëve dhe të cilësisë së kuadrove akademike

PRISHTINË, 20 TETOR - Universitetet publike dhe kolegjet private në Kosovë kanë mungesë të kuadrove akademike në numër, por edhe në cilësi, thonë përfaqësues të organizatave që merren me arsim dhe ekspertë të arsimit.
Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2018/2019 tregojnë se numri i stafit akademik dhe administrativ në universitetet publike në Kosovë është rreth 2 300, ndërsa numri i studentëve është mbi 68 mijë studentë.
Sipas po këtyre të dhënave të ASK-së, vetëm në 14 kolegjet private në Kosovë numri i stafit akademik dhe administrativ ishte 2 339. Të dhënat edhe për 9 kolegje të tjera private mungojnë. Numri i studentëve në kolegje private është mbi 36 mijë studentë.
Eksperti i çështjeve të arsimit, Dukagjin Pupovci, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ka mungesë të kuadrove edhe në numër, edhe në cilësi në universitete publike dhe private. "Nëse shihen përpjesëtimet student - mësimdhënës para dy vjetëve, Universiteti i Prishtinës ka pasur një mësimdhënës për 53 studentë, ndërsa universitetet tjera që janë nëpër regjione kanë qenë në pozitë edhe më të keqe që tregon se vetë numri i mësimdhënësve ka qenë i pamjaftueshëm. Mesatarja në universitetet publike ka qenë një mësimdhënës për 60 studentë, ndërsa në kolegjet private kanë qenë një mësimdhënës për 27 studentë. Këto janë të dhënat e vitit 2017. Tash mund të ketë ndërruar për të mirë kjo situatë por, megjithatë, nuk ka mundur të ndryshojë shumë", ka deklaruar Pupovci.
Në Kosovë dispozitat ligjore parashohin që çdo vit institucionet e arsimit të lartë duhet ta deklarojnë stafin e vet mësimdhënës. Ato dispozita ligjore parashohin se duhet të ketë një doktor shkence për çdo 60 kredi që i ka një program i caktuar studimor. Për shembull, nëse janë 180 kredi, programi trevjeçar duhet t'i ketë tre doktorë në fushën e caktuar.
Rinor Qehaja, drejtor në Institutin për Studime të Arsimit "EdGuard", thotë për "Radion Evropa e Lirë" se e keqja qëndron se sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë është përkufizuar vetëm në plotësimin e numrit të doktorshkencave, pra në aspektin kuantitativ, por mungon sigurimi i cilësisë në mësimdhënie. "Mungesa e kuadrove në Kosovë është më shumë në përgatitjen profesionale sesa në certifikimin e tyre, pra shumë universitete bartëse të arsimit të lartë e përmbushin disi kriterin e tre doktorëve të shkencave, por ajo që është e debatueshme është cilësia në mësimdhënie dhe kualiteti prej këtyre profesorëve. Pra, mungon një mësimdhënie që është e përshtatshme për treg të punës. Tregu i punës na ka dëshmuar se shkollimi universitar nuk i përgatit studentët për tregun e punës", ka thënë Qehaja.
Ndërsa eksperti i arsimit, Dukagjin Pupovci, ka shtuar se problemi më i madh në sistemin e arsimit të lartë është struktura e stafit akademik. Sipas tij, rreth 60 për qind e studentëve në Kosovë studiojnë shkenca sociale dhe humane, që do të thotë se ata nuk kanë nevojë për pajisje laboratorike, por vetëm për libra dhe mësimdhënie cilësore. "Është pikëpyetje sa janë këta njerëz të kualifikuar për të ofruar cilësi në ato vende ku punojnë, pasi që e dimë se në vitet e fundit është bërë pranimi i stafit akademik pa kritere rigoroze akademike, sidomos kjo ka ndodhur në universitet rajonale dhe kolegje. Kanë ardhur njerëz me doktorata prej disa universiteteve private të Ballkanit që tani i kanë zënë vendet. Unë lejoj mundësinë që në mesin e tyre të ketë shumë të mirë, mirëpo në përgjithësi ato institucione ku janë marrë ata tituj janë mjaft problematikë dhe kjo ngreh shqetësimin për kuadrot akademike që kanë institucionet tona të arsimit të lartë", ka deklaruar Pupovci.
Sektori i arsimit në Kosovë për vite me radhë është përballur me probleme të mëdha dhe, si rrjedhojë, edhe me cilësi jo të kënaqshme. Së fundi, Agjencia e Kosovës për Akreditim nuk kishte akredituar tre universitete publike dhe disa prej kolegjeve private. Këto universitete dhe kolegje private kishin marrë vërejtje të shumta nga ekspertët ndërkombëtarë. Ato nuk kishin përmbushur një numër të konsiderueshëm të standardeve të cilat kërkohen, siç janë: stafi, vizioni, cilësia, strategjia dhe elemente të tjera.



Bujar Tërstena (RFE/RL)

# Për nëntë muaj policia ka konfiskuar 892 armë pa leje

PRISHTINË, 20 TETOR - Policia e Kosovës për nëntë muaj ka konfiskuar 892 armë të cilat janë mbajtur ilegalisht nga qytetarët. Bazuar në statistikat e policisë, që nga viti 2016 qytetarët kanë mbajtur 4 625 armë pa leje.
Eksperti i Sigurisë, Drizan Shala, ka thënë për "Ekonomia Online" se iniciativa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për legalizimin e armëve është e dështuar, pasi vetëm një numër i vogël i armëve janë legalizuar dhe dorëzuar.
Andaj, sipas tij, armët të cilët janë në duart e qytetarëve e cenojnë drejtpërdrejt sigurinë dhe mirëqenien e tyre. "Një raport nga organizata ndërkombëtare për siguri, OSBE, e cila vepron në Kosovë, ka dalë në përfundim se në duart e qytetarëve të Kosovës ekzistojnë rreth 200 mijë armë të vogla, një pjesë e të cilave nuk janë të legalizuara dhe kanë mbetur si mbetje që nga pas lufta", ka thënë Shala.
Ai ka theksuar se shpeshherë qytetarët mundohen t'i zgjidhin problemet vetë dhe përfundojnë edhe me fatalitet. Shala ka kërkuar nga organet kompetente të gjejnë një mënyrë e cila i josh qytetarët t'i dorëzojnë armët e tyre ose, sipas tij, të shkurtohen procedurat për legalizim.



# Idetë e kundërta kombit nuk i duhen për shkatërrim, por për zhvillim



Jakup KRASNIQI

Kushdo që mendon se krahu i luftës (si politikë) duhet të lidhet vetëm me UÇK-në e ka gabim, pasi krahu i rezistencës kombëtare shtrihet në disa gjenerata, sidomos të atyre që jetuan, vepruan, luftuan dhe ëndërruan pandërprerë deri te lufta përfundimtare çlirimtare e 1999-s, por edhe asaj që tashmë ka arritur moshë pjekurie që nga përfundimi i saj. Luftën, në përgjithësi, gjë e ditur kjo, por luftën çlirimtare në veçanti, askund në botë popujt nuk e kanë zgjidhje të dëshirueshme, por të imponuar. Ndoshta përkufizimin më të mirë për këtë e ka dhënë Gjergj Kastrioti Skënderbeu i cili ka thënë: "Të kërkosh luftë është çmenduri, por t'i përgjigjesh asaj kur ta imponojnë të tjerët është urti, është mençuri"! Dhe kombi ynë kurrë nuk ka pasur më shumë nevojë sesa sot për një burrështetas të mençur, i cili rrethohet nga bashkëpunëtorë të ditur e besnikë të atdheut.

Gjithashtu, është e vërtetë se pjesëtarët e UÇK-së kanë qenë pakicë, por lufta çlirimtare është bërë për çlirimin e Kosovës, është bërë për lirinë e të gjithë qytetarëve të saj, edhe të atyre që kishin lidhje të shumëfishta me Jugosllavinë e Titos e patën nevojën që të shkëputeshin nga ajo. Lëvizja Kombëtare Klandestine me Ushtrinë Çlirimtare ua dhanë atë mundësi. Nëse individë të caktuar pas luftës çlirimtare janë shndërruar në lakmitarë e grabitës, të korruptuar e haraçexhinj qoftë nga padija, qoftë nga motive të ulëta, panjerëzia, duke u bërë gogolë të së keqes. Gogolë të tillë kanë gjeneruar edhe vendet më demokratike të botës, por kjo sortë e njerëzve askund, as tek ne, nuk mund ta rrëmbejë as idealin, as vizionin e njerëzve që iu kanë prirë proceseve liridashëse e çlirimtare.

Pra, duhet të jemi të vetëdijshëm se edhe ata që i udhëhoqën idetë e rilindësve, të pavarësistëve, të demokratëve apo të komunistëve, nuk kanë qenë shumicë, por iu kanë shërbyer shumicës së shqiptarëve. Dihet se njerëzit me ideale, me integritet e vizion, kudo e kurdo kanë qenë e janë pakicë. Vetëm ne shqiptarët mendojmë se të gjithë janë Skënderbeg a Enver Hoxha, Mic Sokola a Adem Jashara, se të gjithë janë të gjithëdijshëm e hekurin e hanë me dhëmbë, se të gjithë mund të bëhen deputetë a ministra, kryeministra a presidentë pa ia ditur hallin vetes!

Njëzet vjet pas Luftës Çlirimtare kemi gjeneratën më vitale të kombit, e cila nuk lidhet as me pacifizmin e paraluftës, as me Lëvizjen Klandestine për Çlirim, as me Luftën Çlirimtare, madje as me argatët e jugosllavizmit. Kjo është gjenerata e Lirisë dhe e Pavarësisë së Kosovës. Në Kosovën e lirë e të pavarur, kjo gjeneratë ka kërkesa të tjera, kërkesa në rrethana lirie dhe pavarësie. Këto aspirata të reja kërkojnë që të kenë drejtues me vizion të qartë për kombin e shtetin. Sigurisht jo ata që i kishim në 20/30 vjetët e fundit.

Gjenerata e lirisë dhe e pavarësisë duhet ta dijë të kaluarën, por nuk mund të jetojë me lavdinë e djeshme. Kësaj gjenerate i duhet jeta në të sotmen dhe përgatitja për të ardhmen! Gjeneratës që po e përjeton dhe gëzon pavarësinë i duhet perspektiva, e cila nuk ndërtohet me sharje e britma, e as me ndarjet armiqësore të historisë. Qytetarëve tanë iu duhen parti ideologjike e demokratike që i nxjerrin ata nga labirintet e ndarjeve historike me oferta programore për një perspektivë zhvillimi, arsimimi, punësimi e mirëqenieje. Kjo politikë e ky vizion u duhet shqiptarëve sot! Ndonëse njerëzit e dëshmuar për veprimtari atdhetare, të tri dekadave të fundit të shekullit XX, edhe pse kishte në lista zgjedhore të 6 tetorit 2019 në të gjitha partitë politike, mbeten jashtë Kuvendit të ardhshëm, përkundër përvojës së tyre të madhe e të dëshmuar kombëtare e politike. Ndoshta ishte rastësi, ndoshta! Apo, mbase, nuk ishte koha e tyre ashtu si nuk ishte koha e kreshnikut Mujë pas zbulimit të barotit?!

Por, një gjë është e sigurt, ata që e mbërthejnë kombin në korridoret e errëta të historisë së shkuar, të lënë pa ardhmëri! Kombit i duhen idetë e kundërta e përparimtare për zhvillim e përparim, por jo "idetë" për konfrontim e shkatërrim!

Shkurt: Kosova nuk duhet të udhëhiqet as nga të vjetrit apo të rinjtë si moshë, shteti duhet të udhëhiqet nga njerëzit që dinë, duan e kanë vizion se si drejtohet shteti! Përvoja, kujtesa e përkushtimi i njerëzve është shfrytëzuar në çdo epokë të historisë, edhe në ato më primitive, pse koha jonë dhe vetëm për ne të jetë ndryshe?

# Largohen kioskat e vendosura në afërsi të objektit të Komunës në Mitrovicë




Mitrovicës, 20 tetor (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në kuadër të aktiviteteve për të vënë rregull në sferën e ndërtimit ka shtuar këto ditë inspektimet në terren për t'i ndaluar ndërtimet pa leje në qytetin e Mitrovicës. Me këtë rast inspektorët komunalë me asistencë të Policisë së Kosovës kanë ndërmarrë një aksion duke bërë largimin e tri kioskave të vendosura në afërsi të objektit të komunës, të cilat operonin pa leje, përgjatë rrugës "Bedri Gjinaj", në mënyrë që të lirohet hapësira e uzurpuar komunale. Me këtë rast, drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka theksuar se aksionet e tilla do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, andaj ai paraprakisht tërheq vërejtjen për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe ndaljen e ndërtimeve pa leje, duke udhëzuar pronarët që të pajisen me leje urbanistike dhe ndërtimore nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim. "Drejtoria e Inspeksionit nuk do të lejojë asnjë ndërtim pa pasur leje adekuate nga organi kompetent dhe ndaj personave të tillë do të ndërmerren të gjitha masat ligjore", ka thënë drejtori Ahmeti. Ai ka theksuar se investitori, i cili, pavarësisht prej paralajmërimit, nuk ndërmerr asgjë për t'u pajisur me leje ndërtimi, atëherë inspeksioni do të detyrohet që në bazë të ligjit t'i ndalojë punimet në objekte dhe t'i vijojë masat e tjera tek organet kompetente.

Drejtori Ahmeti gjithashtu shtoi se Komuna e Mitrovicës është e angazhuar që ta zbatojë ligjin pa kompromis, andaj kërkojnë nga të gjithë ndërtuesit që të mos e bëjnë as edhe një milimetër ndërtim pa leje paraprake, si dhe të mos i tejkalojnë lejet e ndërtimit me qëllim të respektimit të ligjshmërisë.

Bisedë me ekspertin amerikan të energjisë Gary Dirks

# Dirks: Kosovës i nevojitet një burim stabil i gjenerimit të energjisë elektrike

Eksperti amerikan i energjisë, profesor në Universitetin e Arizonës, Gary Dirks, i cili tashmë është angazhuar në bordin këshillëdhënës për sektorin privat në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosovës i nevojitet një burim stabil i gjenerimit të energjisë elektrike. Ai ka pohuar se mosimplementimi i marrëveshjes për ndërtimin e termocentralit "Kosova e re" nga ana e shtetit të Kosovës do të ishte jomençuri. Dirks ka theksuar se risku për të investuar në Kosovë për investitorët e huaj tani është më i ulët se para pesë apo gjashtë vjetësh



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 TETOR - Eksperti amerikan i energjisë, profesor në Universitetin e Arizonës (Arizona State University), Gary Dirks, i cili tashmë është angazhuar në bordin këshillëdhënës për sektorin privat në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ambienti i të bërit biznes në Kosovë ka shënuar përparim dhe nuk është risku i njëjtë për investitorët e huaj siç ishte para pesë apo gjashtë vjetësh. "Mendoj se në vendin tuaj të rinjtë, forca rinore dhe dinamizmi i tyre për punë janë përparësi krahasuese. Edhe pse keni kaluar nëpër sfida të ndryshme politike, tani vendi juaj është stabil dhe risku politik për të investuar tani në Kosovë është shumë më i vogël se para pesë apo gjashtë vjetëve. Po ashtu, në sistemin e edukimit keni të rinj që janë duke u shkolluar jashtë dhe që përbën potencial për Kosovën absorbim i njohurive të tyre. Në aspektin afatmesëm, në kuptim të tregut, keni mundësi të keni oferta atraktive dhe produktive, pra keni avancime edhe në pjesën e IT-së. Përparësi tjetër që mund ta keni është dhe riciklimi që mund të jetë indicie për hyrje të firmave të mëdha në tregun tuaj. I përmenda këto vetëm si disa shembuj që mund ta nxisin aktivitetin e firmave të huaja për të investuar në Kosovë", ka thënë Dirks. Ai ka folur edhe për marrëveshjen për ndërtimin e termocentralit "Kosova e re", marrëveshje kjo e cila u nënshkrua më 20 dhjetor të vitit 2017 nga kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, drejtori menaxhues i KEK-ut, Arben Gjukaj dhe kryeshefi ekzekutiv i kompanisë "Countur Global", Joseph Brandt.

Dirks ka thënë se do të ishte jomençuri për Kosovën që mos ta trajtojë seriozisht këtë marrëveshje por, sipas tij, duhet të rishikohen kushtet kontraktuale. "Do të ishte e pamençur për Kosovën që mos ta konsideronte serioz këtë projekt të ndërtimit të termocentralit 'Kosova e re'. Normalisht se Kosovës i nevojitet një burim stabil i gjenerimit të energjisë elektrike, por duhet të keni kushte të favorshme, pra pjesët kontraktuale të jenë të favorshme, si kostoja e ndërtimit, kostoja e financimit dhe gjithçka që ndërlidhet me ndërtimin e këtij termocentrali që janë të përballueshme për ju", është shprehur ai.

Në këtë bisedë për gazetën "Epoka e re", Dirks ka folur edhe për marrëdhëniet ekonomike të Kosovës me Serbinë, për të cilën gjë ka thënë se nga barrierat ekonomike nuk përfiton askush. "Edhe pse nuk jam ekspert i marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë, më lejoni të jap një deklaratë të përgjithshme. Një gjë duhet ta keni të qartë, se askush nuk përfiton nga luftërat tregtare. Shikoni çfarë po ndodhë me tarifat në mes të ShBA-së dhe Kinës, pastaj mes Meksikës dhe Evropës. Çdokush lëndohet nga tarifat. Mendoj se ka mënyra të tjera për t'i arritur objektivat sesa të përdorni masa ndëshkimore ekonomike", ka deklaruar Dirks.

## Borxhi ndaj 'Termokos'-it rreth 15 milionë euro

PRISHTINË, 20 TETOR - "Termokos"-i ditë më parë ka filluar sezonin ngrohës, por kjo ndërmarrje publike po përballet me problemin e inkasimit të borxheve. Janë rreth 15 milionë euro që konsumatorët i kanë borxh "Termokos"-it.

Drejtori i kësaj ndërmarrje, Arsim Fetahu, ka thënë se qytetarët nuk e shfrytëzuan Ligjin për Falje të Borxheve. "Borxhet ndaj kompanisë janë rreth 15 milionë euro, por besoj me masat që jemi duke i ndërmarrë që këtë borxh ta zvogëlojmë minimalisht. Borxhi kryesisht ka të bëjë për periudhën e projektit të koogjenerimit dhe një pjesë e qytetarëve, edhe pse kanë pasur mundësi nëpërmjet ligjit për faljen e borxhit, nuk e kanë shfrytëzuar këtë mundësi dhe ato kanë ngelur dhe vazhdojnë të mbesin dhe me masat që do t'i marrim në këtë sezon dhe sezonin tjetër gjithçka do të rregullohet", ka thënë Fetahu për "EkonomiaOnline".

Ai ka paralajmëruar të gjithë borxhlinjtë që nëse nuk i shlyejnë obligimet ndaj kësaj ndërmarrjeje do të marrin masa, duke mos përjashtuar edhe shkyçjet masive.

Fetahu ka bërë me dije se këtë vit në sistemin ngrohës janë kyçur për herë të parë disa objekte kolektive të reja në Kalabri. Edhe këtë vit çmimet do të jenë të njëjta për konsumatorët privatë, që janë 0.72 centë për metër katror, i cili do të vlejë deri në një vendim tjetër të Zyrës së Rregullatorit për Energji.



# Komuna e Dragashit trajnon mësimdhënësit për zbatimin e kurrikulës së re

DRAGASH, 20 TETOR (ER) - Drejtoria e Arsimit në Komunën e Dragashit ka vazhduar organizimin e trajnimit gjashtëditor me mësimdhënësit për zbatimin në praktikë të kurrikulës së re. Kjo komunë ka bërë me dije se ky trajnim është organizuar me qëllim të ngritjes së njohurive dhe aftësive të mësimdhënësve për mënyrën e mësimdhënies dhe zbatimin e kurrikulës së re. "Drejtoria Komunale e Arsimit ka organizuar një trajnim gjashtëditor me temën: 'Zbatimi në praktikë i kurrikulës së Kosovës'. Trajnimi disajavësh është zhvilluar në disa seminare të ndryshme dhe në disa tema: 'Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar në Kosovë', 'Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës së re', 'Metodologjia e mësimdhënies, materialet mësimore dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve'. Mësimdhënësit përmes këtij trajnimi kishin mundësi të përfitojnë njohuri për kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar në Kosovë, për rëndësinë dhe zbatimin e saj në praktikë, për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re dhe për vlerësimin e arritjeve te nxënësit", ka njoftuar Komuna e Dragashit.





# Fillojnë punimet infrastrukturore në lagjen 'Pejton'

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Duke filluar nga dita e hënë, 21 tetor, rruga "Nazmi Mustafa" do të jetë e mbyllur për qarkullim me automjete. Në lagjen "Pejton" po fillojnë punimet për zbatimin e projektit për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe rrugëve në këtë lagje. "Lusim banorët për bashkëpunim, fillimisht duke i larguar veturat e parkuara në këtë rrugë, në mënyrë që të mundësohet qasja në pjesët ku do të punohet. Falënderojmë qytetarët paraprakisht për mirëkuptimin dhe i lusim që gjatë kësaj kohe t'i shfrytëzojnë rrugët alternative për qarkullim në këtë pjesë të qytetit", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

# Fillon asfaltimi i rrugicave dhe parkingjeve në Skenderaj

SKENDERAJ, 20 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se sot ka filluar asfaltimi i rrugicave dhe parkingjeve brenda zonës urbane në qytet. Ai ka thënë se tashmë banorët do të kenë qasje më të mirë dhe më moderne në këtë zonë urbanistike. "E gëzofshin banorët e kësaj pjese!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".



# Komuna e Prishtinës do t'i rregullojë të gjitha këndet e lodrave

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se do të riparohen të gjitha këndet e lodrave në kryeqytet. "Komuna e Prishtinës ka kontraktuar Ndërmarrjen Publike Banesore për mirëmbajtjen e të gjitha këndeve të lodrave në Prishtinë. Tashmë janë riparuar një pjesë e tyre. Në çdo park të fëmijëve e keni edhe tabelën me numër të telefonit ku mund t'i lajmëroni prishjet për rregullimin e menjëhershëm të tyre", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



# Tetori, muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit

LIPJAN, 20 TETOR (ER) - Muaji tetor ose muaji rozë, siç njihet në botë, është muaji përgjatë të cilit zhvillohen aktivitete të ndryshme të cilat kanë për qëllim promovimin dhe edukimin shëndetësor me synim të parandalimit dhe trajtimin e kancerit të gjirit. Andaj edhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Lipjanit gjatë këtij muaji, përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Njësinë e Diagnostikës, do të mundësojë që ekzaminimi i gjirit të bëhet pa pagesë për të gjitha gratë të cilat kanë rekomandimin e mjekut për një gjë të tillë. "Kanceri i gjirit është sëmundja më e shpeshtë kanceroze te gratë dhe një ndër shkaktarët më të shpeshtë të vdekjes së grave të moshës 45-55-vjeçare. Megjithatë, kjo sëmundje mund të trajtohet nëse zbulohet në faza të hershme të zhvillimit të saj", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Lipjanit.



Recension për librin "Kurthet terminologjike në funksion të mohimit të gjenocidit në Kosovë" të autorit Bardhyl Mahmuti

# Një manual i rëndësishëm për gazetarinë dhe shkencat politiko-juridike



Lulëzim ETEMAJ

Pas librit afër 600 faqesh "Mashtrimi i madh", botuar në vitin 2015, përmes të cilit me argumente shkencore, krahas hedhjes dritë dhe argumentimit të gjenocidit serb, demontohet edhe lufta speciale e Serbisë si në rrafshin medial ashtu dhe atë politik, diplomatik dhe juridik, për kriminalizimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ish-drejtuesi i diplomacisë së UÇK-së, politologu Bardhyl Mahmuti, ka sjellë librin e radhës me titullin: "Kurthet terminologjike në funksion të mohimit të gjenocidit në Kosovë". Parahistoriku i shkrimit të librit përfshinë periudhën dymujore nga data 20 prill 2019, kur autori e boton shkrimin e parë, "Shprehja 'krimet e luftës në Kosovë' është e mangët", deri më 21 qershor 2019, kur e boton shkrimin e fundit nga seria e shkrimeve që kanë të bëjnë me terminologjinë mbi krimet serbe të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Libri është botuar nga Qendra "Gjenocidi në Kosovë - plagë e hapur", e themeluar më 30 qershor të këtij viti, ndërsa shpërndahet falas dhe u dedikohet kryesisht gazetarëve, studentëve të rinj dhe kuadrove të shkencave politike, juridike dhe diplomatike. Ky libër paraqet një ndihmesë të madhe posaçërisht për zyrtarët e shtetit të Kosovës, të të gjitha kategorive, për kryerjen e detyrave në interes të vendit, që për qëllim e kanë ndriçimin dhe shpjegimin e krimeve të kryera kundër shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë, si gjenocidi; krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. E, zbardhja dhe shpjegimi i argumentuar i këtyre krimeve do të duhej të çonte jo vetëm në ndëshkimin meritor të kriminelëve nga ana e drejtësisë së Kosovës dhe asaj ndërkombëtare, por edhe të vet shtetit të Serbisë si organizator, zbatues dhe mbikëqyrës i tyre.

Gjithsesi, nga ky libër mund të përfitojnë të gjithë ata lexues që, krahas motiveve të tjera, edhe në shenjë respekti dhe nderimi të viktimave, familjarë, të njohshëm apo thjesht bashkëkombës, janë të interesuar që të mos bien pre e kurtheve terminologjike, duke përdorur terme të gabuara, përmes të cilave synohet mohimi i gjenocidit serb në Kosovë.

Struktura e librit "Kurthet terminologjike në funksion të mohimit të gjenocidit në Kosovë" përbëhet nga 11 trajtesa të zgjedhura, si: "Shprehja 'krimet e luftës në Kosovë' është e mangët"; "Holokausti, gjenocidi dhe shoah"; "Gjenocidi dhe termi 'zhdukje'"; "Gjenocidi dhe termi 'shfarosje'"; "Gjenocidi, termi asgjësim dhe Kodi Penal i Kosovës"; "Përgjegjësia individuale dhe shtetërore në krimin e gjenocidit"; "Nocioni 'paramilitar' si instrument i mohimit të gjenocidit"; "Qëllimi dhe mënyra e kryerjes së krimit": "Gjenocidi dhe masakra"; "Jo 'eksodi', por 'spastrimi etnik' është akt i gjenocidit"; "Në cilat raste dhuna seksuale është akt i gjenocidit?"; "Në rastin e Kosovës edhe shkatërrimet janë dëshmi e qëllimit të Serbisë për gjenocid".

Trajtesat janë punuar me një përkushtim të veçantë, ndërsa janë mbështetur edhe me argumente të nevojshme shkencore, duke iu referuar edhe akteve të ndryshme politike e juridike ndërkombëtare, përfshirë edhe Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit si dhe Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, gjë që i bën ato më shpjeguese dhe më lehtë të kuptueshme për lexuesit e kategorive të ndryshme, si sociale ashtu dhe profesionale.

Vetë fakti se tek pas 20 vjetësh të çlirimit, gjegjësisht 11 vjetësh shtet, Kuvendi i Kosovës, më 16 maj 2019, me votat e 79 deputetëve të pranishëm në seancë, e miraton Rezolutën për gjenocidin serb të kryer në Kosovë, flet për domosdoshmërinë e angazhimit më të madh dhe më të avancuar të shoqërisë sonë, madje edhe përmes nxjerrjes së manualëve të tillë të domosdoshëm, siç ka vepruar në këtë rast politologu Bardhyl Mahmuti, në mënyrë që veprimtaria shumëdimensionale për ndriçimin e të gjitha krimeve serbe të kryera gjatë luftës në Kosovë ta arrijë rezultatin e synuar pozitiv dhe drejtësia ta thotë fjalën e vet meritore.

Paraprakisht, më 12 prill 2019 Bardhyl Mahmuti ia ka ofruar Kuvendit të Kosovës projektrezolutën e hartuar prej tij për gjenocidin serb në Kosovë.

"Kurthet terminologjike në funksion të mohimit të gjenocidit në Kosovë", është një manual i veçantë dhe i rëndësishëm për të gjithë të interesuarit që t'i quajnë me emrin e vërtetë krimet e Serbisë të kryera gjatë luftës në Kosovë, posaçërisht për studiuesit dhe të gjithë ata që, shkaku i profesionit apo vetëm i pasionit, merren me gazetari apo shkenca politiko-juridike.

# BALLKANI MES PAQES DHE GJEOPOLITIZIMIT



**Dr. Edita TAHIRI,**
*ish-zëvendëskryeministre dhe kryenegociatore*

Kishte një lajm të shkëlqyeshëm në Kosovë. Opozita fitoi zgjedhjet. Kjo tregoi se njerëzit dëshironin ndryshime dhe kultura politike po rritet për funksionalitetin e demokracisë në Kosovë. Partitë që qeverisën gjatë, veçanërisht ajo më e madhja, PDK-ja, por edhe të tjerat, humbën zgjedhjet. Unë mendoj se kjo votë ishte votë e dënimit për keqqeverisjen dhe korrupsionin, por për pjesën më të madhe ishte votë që goditi disa lojëra gjeopolitike të cilat rrethuan dialogun e Brukselit me idetë e rrezikshme të ndryshimit të kufijve, në të cilat ishte përfshirë edhe presidenti i Kosovës, presidenti serb Vuçiq, kryeministri i Shqipërisë dhe një listë e gjatë e lobistëve. Pra, kjo ishte goditje për atë lloj skenari. Edhe një herë populli i Kosovës tregoi se kufijtë e Kosovës nuk janë kufij që mund të ndryshojnë lehtësisht, ne kemi luftuar për ta 100 vjet.

Të gjithë duhet ta dinë se në Ballkan kufijtë nuk mund të ndryshojnë pa luftëra, ne i vendosëm ato me luftëra, dhe nëse do të ndryshonin, për fat të keq do të çonin në luftëra të reja.

Unë dola menjëherë në këtë çështje më të madhe të gjeopolitikës, sepse sinqerisht vetë si një prej liderëve të pavarësisë së Kosovës dhe krijimit të shtetit, që punoj tash 30 vjet për Kosovën, por edhe për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe për vizionin euroatlantik të rajonit tonë, nuk do ta besoja që Ballkani nuk mund të bënte hapa të mëdhenj për të dalë nga Ballkanizimi dhe të përvetësoj evropianizmin. Në një farë mënyre, këto kohë, Ballkani është mbërthyer nga gjeopolitizimi, kjo përkundër faktit se ne luftuam për Evropianizim.

Çfarë ndodhi? Së pari, jo se ne vendet e Ballkanit nuk kemi vizion të qartë për integrimin euroatlantik, por mbase nuk mundëm ta demonstronim përmes reformave të thella, për shkak të urisë së madhe për korrupsion dhe pasurime personale, duke i lënë vendet tona mjaft të dobëta dhe të pazhvilluara. Së dyti, ne u përballëm kohët e fundit me një Bashkim Evropian që fliste me dy zëra. Unë pashë dy Evropa, shpresojmë të unifikohet kur të vijë udhëheqja e re së shpejti. Një zë i Bashkimit Evropian i disa zyrtarëve që hapën, me lehtësi e komoditet, hapësirë për diskutime për ndryshimin e kufijve në Ballkan. Jam e sigurt që të tillët nuk janë në dijeni se çfarë do të thotë kjo për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe Evropën, pra tentuan ta prekin një kufi duke mos ditur se do të përhapej gjithandej në rajon. Dhe, një tjetër zë i qëndrueshëm i vendeve udhëheqëse evropiane, të cilët ishin konsekuent në atë që ju premtuat si Evropë për ne. Kur ndodhi Agjenda e Selanikut në 2003, ne të gjithë ishim me shpresë për paqen dhe ëndrra jonë po bëhej realitet. Ne kishim një ëndërr pavarësinë që e morëm dhe, ëndrra tjetër ishte integrimi euroatlantik. Por, kur pamë që zonja Mogherini po hap një hapësirë për diskutime mes Kosovës dhe Serbisë për ndryshim kufijsh, ndërkohë që unë vetë punova, e mbylla dhe e përcaktova atë kufi në dialogun e Brukselit dhe po ashtu riintegrimin e serbëve të veriut e Kosovës, dhe Serbia bashkëpunoi, pyetja ime është çka ka ndodhur?

Çfarë po ndodh në të vërtetë? Unë mendoj se ka forca që pretendojnë për ta dominuar Ballkanin, në këtë rast është Serbia e cila nuk dëshiron ta shohë Ballkanin e barabartëve. Mirëpo, ka një Evropë dhe një ShBA dhe të tjerët që të shohin këtë dhe ta mbështesin Ballkanin e të barabartëve. Këto ditë u përballëm edhe me idenë e Shengenit për Ballkanin në rajonin tonë, ndërsa ne të gjithë duam të shkojmë në Evropë. Çfarë është kjo krijesë e re që i imponohet Ballkanit? A është për Evropën që të qetësojë veten që po vonon të na pranojë, apo mos vallë është se duan të sjellin një dominues në Ballkan që është Serbia dhe këtë herë Serbia me Rusinë përsëri të kthyer në rajon.

Ne pas përfundimit të Luftës së Ftohtë luftuam vërtetë që vendet tona dhe rajoni ynë të jenë perëndimorë, të jenë demokratikë dhe euroatlantikë, në mënyrë që të heqim qafe ndikimet e Rusisë dhe të mos përmend Kinën. Dy gjëra, do të dëshiroja të them si përfundime. Së pari, shpresoj se Evropa po shkon drejt vizionit dhe zërit më të bashkuar, sepse ne i dimë ndarjet aktuale në Bashkimin Evropian, madje edhe Kosova i ndien, ende nuk është njohur nga pesë vende anëtare të BE-së. Por nëse Evropa nuk di si të unifikohet, atëherë do të jetë shumë më e vështirë për të gjithë ne, për Kosovën, Ballkanin dhe Evropën. Së dyti, është koha që Evropa të përcaktojë nëse Evropa është me Ballkanin brenda apo me Ballkanin jashtë, që mos t'ia lëmë Ballkanin gjeopolitikës së kombeve të urritura, atyre që humbën Luftën e Ftohtë.

**(Ky fjalim është mbajtur në Samitin e 15-të për Evropën dhe Paqen, në Salzburg, Austri, më 7 tetor 2019)**

## BE-ja shtyn vendimin për shtyrjen e sërishme të Brexit-it

**Bruksel, 20 tetor** - Bashkimi Evropian nuk do të ngutet dhe do të shtyjë shkurtimisht vendimin përfundimtar mbi kërkesën e kryeministrit të Britanisë së Madhe Boris Johnson për shtyrjen e serishme të Brexit, thanë diplomatë të paemëruar evropianë pas takimit të shkurtër të dielën.
Parlamenti britanik nuk pranoi të votojë të shtunën mbi marrëveshjen e re të Johnson për Brexit, duke e bërë atë të kërkojë një shtyrje të tretë për daljen e vendit nga BE.
Deri më tani, Britania ishte planifikuar të largohej nga BE më 31 tetor. Në mbledhjen e rrallë javore të ambasadorëve të 27 vendeve anëtare, u vendos që marrëveshja me Johnson të dërgohet në Parlamentin Evropian për miratim.
Parlamenti Evropian do të takohet në Strasburg javën e ardhshme.
"Ne jemi duke pritur të shohim se si po shkojnë gjërat deri në fund të javës, duke shpresuar se deri atëherë do të shohim se si po shkojnë gjërat në Londër", tha një diplomat i lartë evropian. Një diplomat tjetër tha se takimi ishte i shkurtër, pa pyetje dhe diskutim.
"Po presim", shtoi ai.
Presidenti i Këshillit Evropian Donald Tusk tha të shtunën se kishte marrë një kërkesë për shtyrje dhe do të këshillohej me kryeqytetet evropiane se si t'i përgjigjej kësaj.
Drejtuesit e BE-së nuk duan largimin e çrregullt të Britanisë nga BE-ja dhe nuk kanë gjasa ta refuzojnë kërkesën, transmeton Reuters



# Ligjvënësit britanikë mbështesin shtyrjen e Brexit-it

> Ligjvënësit britanikë të Partisë së Bashkimit Demokratik votuan amendamentin e quajtur Letwin, duke hedhur poshtë propozimet e kryeministrit dhe kjo parti mbështet daljen nga Bashkimi Evropian, por nuk qëndron me propozimet e Johnsonit për Irlandën Veriore



**Londër, 20 tetor** - Ligjvënësit britanikë kanë votuar një amendament që mund të shtyjë procesin e daljes nga Bashkimi Evropian, derisa të gjitha ligjet të kalojnë në Parlament.
Ligjvënësit britanikë të Partisë së Bashkimit Demokratik votuan amendamentin e quajtur Letwin, duke hedhur poshtë propozimet e kryeministrit Boris Johnson.
Kjo parti mbështet daljen nga Bashkimi Evropian, por nuk qëndron me propozimet e kryeministrit Johnson për Irlandën Veriore.
Ligjvënësit britanikë u mblodhën të shtunën ku pritej që të votohej marrëveshja e arritur mes Bashkimit Evropian dhe kryeministrit Johnson, por votimi u shty me anë të këtij amendamenti.
Ky amendament e ndalon miratimin e marrëveshjes derisa i tërë legjislacioni të miratohet në Parlament - veprim ky i cili automatikisht e obligon kryeministrin të kërkojë shtyrjen e datës deri më 31 janar.
Por, kryeministri Johnson tha se nuk do të kërkojë nga BE-ja shtyrje të afatit dhe se do të hedhë në votim propozimin sërish javën e ardhshme.
Deputetë të Bashkimit Demokratik kanë deklaruar se "ne do të dështojmë në përgjegjësitë tona nëse nuk përdorim çdo strategji" për të siguruar këto ndryshime në marrëveshje.
Në anën tjetër, mijëra protestues u mblodhën para Parlamentit britanik duke kundërshtuar marrëveshjen e arritur me Bashkimin Evropian dhe propozimet e kryeministrit Johnson.
Mbështetësit e kampanjës "Vota e popullit", deklaruan se ata duan të sigurojnë që Mbretëria e Bashkuar është e lumtur që do të largohet nga BE-ja, nën marrëveshjen e arritur.
Ata kishin veshur bluza, kapela dhe mbanin flamuj që tregojnë përkrahjen e vazhdimit të qëndrimit në bllokun evropian.
Sipas marrëveshjes, Irlanda Veriore mbetet në zonën doganore të Britanisë së Madhe, por nën një sistem kompleks, por të gjitha procedurat e BE-së do të zbatohen atje për mallrat që mbërrijnë.
Nuk do të ketë kontrolle doganore në ishullin e Irlandës, pasi ato do të bëhen në porte.
Mallrat që shkojnë nga Britania e Madhe në Irlandën Veriore nuk do t'iu nënshtrohen tarifave.
Përfaqësuesit e Irlandës Veriore do të jenë në gjendje të vendosin çdo katër vjet nëse do të vazhdojnë të zbatojnë rregullat e Unionit.
Michele Barnier, shefi negociator i Bashkimit Evropian për Brexit, i kishte thënë BBC-së se pika e fundit, duke lejuar votimin në Asamblenë e Irlandës Veriore, ishte një "gur themel i marrëveshjes së re".
Marrëveshja mes Johnsonit dhe Bashkimit Evropian është rishikuar të enjten në samitin e Brukselit. Kryeministri Johnson ka insistuar që nuk do ta shtyjë në asnjë mënyrë afatin e përcaktuar më 31 tetor për dalje nga BE-ja, duke bërë thirrje që të gjithë deputetët të mbështesin marrëveshjen e re.
Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundrejt 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

## Trupat amerikane tërhiqen nga baza më e madhe në veri të Sirisë

**Uashington, 20 tetor** - Trupat amerikane u tërhoqën nga baza e tyre më e madhe në veri të Sirisë të dielën. Sekretari amerikan i Mbrojtjes Mark Esper tha se të gjitha forcat amerikane që u larguan nga Siria do të vendosen në Irakun Perëndimor dhe do të vazhdojnë të kryejnë operacione antiterroriste kundër Shtetit Islamik në rajon.
Sekretari Esper tha se më shumë se 700 trupa amerikane do të zhvendoseshin në Irak dhe nuk do të ktheheshin në Shtetet e Bashkuara së shpejti, siç ka sugjeruar presidenti Donald Trump.
Shefi i Pentagonit nuk e përjashtoi mundësinë e sulmeve amerikane kundër terrorizmit nga Iraku në Siri. Por ai tha se planet do të zhvilloheshin me kalimin e kohës dhe përfshijnë diskutime me aleatët në një takim të NATO-s në ditët e ardhshme. Ai tha se nëse forcat amerikane kthehen në Siri ato do të mbrohen nga avionët luftarakë amerikanë.
Shtetet e Bashkuara kanë aktualisht rreth 5000 trupa në Irak sipas një marrëveshjeje midis Bagdadit dhe Uashingtonit. Shtetet e Bashkuara u tërhoqën në vitin 2011 kur operacionet luftarake përfunduan, por u kthyen përsëri pas tre vjetësh kur Shteti Islamik mori nën kontroll një numër të madh të vendit para se ta humbasë atë më vonë.


Reuters


Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

# Tërmeti zgjoi rrezikun 500-vjeçar



Tërmetet që u regjistruan këtë verë në shtetin amerikan që njihet për tërmete, Kaliforninë, bënë më tepër se thjesht ta shkundnin tokën, sipas shkencëtarëve. Tërmeti nisi më 4 korrik me një shkundje paralajmëruese me magnitudë 6.4, tërmeti kryesor erdhi pas 36 orësh me magnitudë 7.1, të vegjlit që pasuan ishin të panumërt, rreth 100 mijë. Kjo dukuri ishte më e fuqishmja në 20 vjetët e fundit për zonën, por tani shkencëtarët mendojnë se ka vënë në lëvizje 20 pllaka të tjera më të vogla. Këto pllaka nuk i njihnin deri më sot dhe kanë qenë pa lëvizur për rreth 500 vjet. "Me pak fjalë, nuk e dimë se ç'do të thotë. Por është befasuese, sepse nuk ishte parë ndonjëherë pllaka në zonën Garlok që të lëvizte", ka thënë gjeologu i Universitetit të Kalifornisë, Zakari Ros.

FOTO E DITES




Hëna shihet pas Qendrës Botërore të Tregtisë në Nju Jork. /AP/

E jashtëzakonshme

# Burri me 39 gra kërkon nuse



Një burrë që ka 39 gra, 94 fëmijë dhe 33 nipër, nuk mendon se familja e tij është e plotësuar. Ziona Çana, një patriark i krishterë nga India, thotë se është gati të martohet sërish. Duke qenë një familje aq e madhe, ata janë të preferuarit e politikanëve të zonës, për shumë vota. Ziona jeton me gratë, fëmijët dhe nipërit, në shtetin Mizoram të Indisë, në zonën verilindore të vendit. Familja e tij quhet më e madhja në botë dhe është një sekt patriarkal i krishterë. Të gjithë jetojnë në një ndërtesë që ka katër kate dhe 100 dhoma, të ndara në kategori të ndryshme.

## BARSOLETA E DITËS



**Njëri banonte në një ndërtesë në katin e dytë. E kishte bërë shprehi të afrohej te dritarja të pinte cigare dhe duqin ta hidhte jashtë. Një natë një cigare e hodhi jashtë dhe ajo i ra në kokë një udhëtari, i cili, i nervozuar, e pyeti: - Po ti, a s'ke shpuzore në shtëpi, a? pyeti kalimtari. Ky iu përgjigj: Edhe shpuzore dëshiron a?!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

## ABOMINABLE 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton

Çdo ditë në ora 16:00

## TOY STORY 4 / 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

## MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D




Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning

Çdo ditë në ora 22:00

## ZOMBIELAND DOUBLE TAP




Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Sot do të jeni në qejf dhe tepër entuziast. Ditë si kjo e sotmja ju kishte munguar.



**DEMI**
Kjo është një ditë ideale për të medituar. Mendoni çdo situatë që ju shqetëson.



**BINJAKËT**
Sot jeni shumë kreativ. Ka mundësi të mos i jepni rëndësi pasi jeni shumë të përqendruar në punë.



**GAFORRJA**
Përpiquni të jeni të kujdesshëm. Gabimet do t'ju kushtojnë shumë.



**LUANI**
Mund të ndiheni sikur e keni kokën në mes të reve sot, por qëndroni me këmbë në tokë.



**VIRGJËRESHA**
Sot mund të bisedoni me disa njerëz me të cilit kishit kohë që nuk kontaktonit.



**PESHORJA**
Provoni të tregoni durim dhe afeksion për njerëzit që doni. Kjo do t'ju japë shumë pikë.



**AKREPI**
Sot do të keni intuitë aq të fortë sa do të arrini t'i kuptoni dëshirat apo shpresat e dikujt tjetër.



**SHIGJETARI**
Ju ndiheni sikur doni ta ushtroni imagjinatën. Kini parasysh se imagjinata forcohet vetëm në sajë të leximit. Lexoni sa më shumë libra. Niseni me klasikët.



**BRICJAPI**
Nëse dikush ju ka lënduar apo zhgënjyer, hidheni pas krahëve dhe vazhdoni përpara.



**UJORI**
Rezistoni tundimit për të bërë blerje në dyqane. Po vjen fundi i muajit dhe nuk keni luksin të shpenzoni shumë.



**PESHQIT**
Ju jeni shumë sensitiv sot dhe keni një intuitë tepër të fortë.

# Lady Gaga thotë se është beqare



Këngëtarja Lady Gaga ka thënë se është beqare. Gaga, sipas "Daily Mail", ka qenë në lidhje me inxhinierin e zërit Dan Horton. Aktorja e filmit "A Star is Born" këtë e ka bërë me dije me anë të një fotografie të publikuar në "Instagram" ku ka shkruar "Një grua e martuar, gjithashtu edhe unë një vajzë beqare". Gaga në këtë fotografi ishte bashkë me miken e vet Sarah, të cilat ishin në festën e beqarisë të Nicole Tanno të premten që lamë.

# Kate Upton publikon fotografi të rrallë të vajzës




Fansja numër 1 e babait. Kate Upton ka postuar një fotografi në "Instagram", të vajzës së vet Genevieve, 11-muajshe, duke bërë tifo për babanë e vet, Justin Verlanderin, në lojën e tij në bejsboll. "Shko babi, ne jemi gati", ka shkruar Kate poshtë fotografisë së vajzës e cila kishte të veshur një xhaketë prapa së cilës shkruante "Verlander" dhe numrin 35 të Justinit.





# Bebe Rexha e performon këngën e re në emisionin "The Ellen DeGeneres Show"

Këngëtarja e njohur nga Shqipëria, Bebe Rexha, ka publikuar këngën e saj më të re e cila është kolona zanore e filmit, "Maleficent: Mistress Of Evil". Kjo këngë quhet "You Can't Stop The Girl". Rexha pati performancë live të kësaj kënge në skenën e emisionit të famshëm në ShBA "The Ellen DeGeneres Show".

# Fejohet Dennis Quaid



Dennis Quaid është fejuar. Raportohet se aktori 65-vjeçar i propozoi martesë të dashurës së vet Laura Savoie, sipas "Us Weeky". Më 18 tetor çifti u pa në Hawaii. Dennis dhe studentja 26-vjeçare janë parë bashkë që nga muaji qershor. Aktori ka qenë i martuar tri herë dhe ka tre fëmijë nga martesat e mëparshme.

# MARRËZIA IME



Nga: Charles BUKOWSKI
Përktheu: Fadil BAJRAJ

Janë disa shkallë marrëzie, dhe sa më i marrë që je, njerëzit do ta kenë më të qartë. Shumicën e jetës sime marrëzinë time e kam fshehur brenda vetes, por ajo ende është aty. Për shembull, ndonjë person do të më flasë për këtë apo për atë dhe derisa ky person ma shurdhon karin me gjëra bajate, unë e imagjinoj këtë person me kokën e tij a të saj në gijotinë, ose i imagjinoj në një tigan të madh, duke u fërguar, derisa më shikojnë me sy plot frikë. Në situata të tilla, ka të ngjarë se do të përpiqesha t'i shpëtoja por, derisa flasin me mua, s'mund t'i imagjinoj ndryshe. Ose kur jam në orë më të mirë, do të mund t'i përfytyroja si me biçikleta shpejt e shpejt ikin prej meje. Unë, thjesht, kam telashe me qenie njerëzore. Kafshët i dua. Ato nuk gënjejnë dhe rrallëherë përpiqen t'ju sulmojnë. Ndonjëherë mund të jenë dinake, por kjo është e lejueshme, pse?

Pjesa më e madhe e jetës sime rinore dhe pjekurisë ka kaluar në dhoma të vockla. I kruspullosur aty, i zgurdulloja sytë në mure, në grilat e grisura, në doreza sirtarësh. Isha në dijeni për femrën dhe e gjakoja atë, por nuk dëshiroja të kaloja nëpër tërë atë cirk për ta pasur. Edhe për paranë isha në dijeni por prapë, sikur me femrën, nuk doja t'i bëja gjërat që duhej bërë për të ardhur deri tek ajo. E gjitha që doja mjaftonte sall për një dhomë dhe për të pirë. Kam pirë i vetëm, zakonisht në shtrat, me të gjitha grilat e ulura. Ngandonjëherë shkoja në bare për t'i kontrolluar speciet, por speciet nuk ndryshonin – jo edhe aq shumë e shpesh edhe më pak se aq.

Në të gjitha qytetet i kontrolloja bibliotekat. Libër pas libri. Pak libra më kanë thënë gjë. Të shumtën më ishin pluhur në gojë, zall në mendje. Asnjëri nuk kishte të bënte me mua ose me atë si ndihesha: ku isha, askund; çfarë kisha, asgjë; dhe çfarë kërkoja, asgjë. Librat e shekullit përbënin sall fshehtësinë e të pasurit emër, trup, shëtitje, biseda, aty-këtu ndonjë veprim. Askush nuk dukej se merrej me marrëzinë time të veçantë.

Në disa bare bëhesha i dhunshëm, aty ka pasur edhe rrahje nëpër rrugica, shumë nga to i kam humbur. Por nuk luftoja njeri të posaçëm, nuk isha i zemëruar, sall që nuk mund t'i kuptoja njerëzit, çka ishin, çfarë bënin, si dukeshin. Hyja e dilja nga burgjet, më përzinin nga dhomat. Flija në ulëse parqesh, në varreza. Isha i hutuar, por nuk isha i trishtuar. Nuk isha veskeq. Sall që nuk mund të bëja asgjë të hairit nga ajo që më rrethonte. Dhuna ime ishte kundër kurthit të qartë, bërtisja e ata nuk më kuptonin. Bile edhe në rrahjet më të çoroditura e shikoja kundërshtarin tim dhe mendoja, pse është i inatosur? Ai dëshiron të më vrasë. Atëherë më duhej ta godisja që ta heq qafe bishën. Njerëzit nuk kanë sens të humo-rit, ata janë tepër serioz ndaj vetes.

Diku në të gjithë këtë nuk kam ide se nga erdhi kjo, ia fillova të mendoj, ndoshta do të duhej të bëhem shkrimtar. Ndoshta do të mund t'i shkruaj fjalët që s'i kam lexuar, ndoshta duke e bërë këtë do ta flak këtë tigër nga shpina. Dhe kështu ia fillova e dekadat u rrokullisën pa më sjellë shumë fat. Tashmë isha shkrimtar i marrë. Më shumë dhoma, më shumë qytete. Zhytesha poshtë e më poshtë. Një herë vdisja nga të ftohtit në Atlantë, në një kasolle prej letre të katranosur, jetoja me një dollar e një çerek në javë. Pa pajisje hidraulike, pa drita, pa ngrohje. Rrija dhe vdisja nga të ftohtit në rrobat e mia kaliforniane. Në një mëngjes e gjeta një fund të vogël lapsi dhe ia fillova të shkruaja poezi anash faqeve të një gazete të vjetër në dysheme.

Më në fund, në moshën 40-vjeçare, libri im i parë u botua, një përmbledhje e vockël me poezi. Lulja, grushti dhe kuja çnjerëzore. Pakoja e librave erdhi me postë dhe, kur e hapa, aty ishin libërthat e vockël. U hapërdanë në trotuar, të gjithë lib-rat e vegjël dhe rashë në gjunjë në mesin e tyre, isha në gjunjë dhe mora Lule grushtin dhe e putha. Kjo ka qenë para 30 vje-tësh.

Ende po shkruaj. Në katër muajt e parë të këtij viti i kam shkruar 250 poezi. Ende e ndiej marrëzinë si më vërshon, por ende nuk e kam shkruar fjalën ashtu siç kam qejf, tigri ende më rri në shpinë. Do të vdes me atë bir kurve në shpinë që, megjithatë, e kam luftuar. Dhe në qoftë se ekziston njeri që ende e ndien veten tamam të krisur për t'u bërë shkrimtar, do t'i them sall vazhdo, pështyje në zemër diellin, bjeri asaj tastiere, është lloji më i mirë i marrëzisë, shekujve u duhet ndihmë, speciet kërkojnë dritë, bixhoz dhe qeshje. Jepu. Ka shumë fjalë për të gjithë ne. */Revista "Akademia"/*

# Fshikullimi i Adil Ollurit

Nga: Albin MEHMETI

Pas dy veprave studimore, fituesi i çmimit ndërkombëtar për letërsi “Pemio Ostana Internazzionale”, Adil Olluri, kthehet para lexuesve me përmbledhjen me tregime “Kthimi i Profetit”, botuar nga shtëpia e njohur botuese “Armagedoni”. Në tetëmbëdhjetë tregime, Olluri trajnon tema nga më të ndryshme, që nga religjioni e nacionalizmi e deri tek krimi e korrupsioni.

Në tregimin “Kthimi i Profetit”, Olluri godet rëndë interpretimin e dhunshëm të fesë islame nga predikuesit. Ai sjellë profetin Muhamed në Prishtinë, të cilin e vë në sprova që ai asnjëherë s’i ka ndeshur në epokën e tij, ku kulmon me largimin e tij nga xhamia, vetëm e vetëm pse ai thërriste në dashurinë ndaj Zotit, dhe jo frikën ndaj Tij, mjet përmes së cilit manipuluesit dhe predikuesit i mbajnë nën kontroll besimtarët.

Profeti Muhamed i Ollurit është ndryshe nga profeti Muhamed të cilin e hasim në mësimet kanonike. Profeti i Ollurit më shumë ngjason me mësuesit bredhës, apo të njohur në mistikën islame si dervishë, të cilët shumicën e kohës e kalojnë nga rruga në rrugë, nga fshati në fshat dhe nga qyteti në qytet për të predikuar në dashuri ndërnjerëzore e mbi të gjitha për dashurinë metafizike. Profeti i Ollurit do të ndeshet me klerikë të paditur, besimtarë të nënshtruar prej këtyre të fundit dhe njerëz që krekosen kur bëjnë punë të mira, gjë që e detyrojnë Profetin të ikë me të shpejtë nga Prishtina. Temën e religjionit, Adil Olluri do të trajtojë edhe në tregimin “Barku i balenës”, ku merr si trajtim mitin biblik dhe kuranor të Jonuzit, mit të cilin do ta rikontekstualizojë dhe ngjarjen do ta zhvillojë në shekullin XXI me topikë shqiptare, përmes së cilës do të godas njerëz të cilët pandehin se bartin flamurin e kodeve të larta morale, por në të vërtetë ato i kanë vetëm se mbulesë të punëve të tyre të liga.

Në të gjitha kulturat botërore qofshin ato religjioze a profane, qofshin monoteiste, ateiste a politeiste, qofshin ato perëndimore apo lindore, respekti ndaj të vdekurve ishte maksimal, ku shpeshherë merrte edhe premisat e shenjtërisë. Se deri ku është degraduar morali ynë e tregon tregimi “Tender për transport kufomash”, ku autori godet fenomenet e nepotizmit dhe të korrupsionit, fenomene që tanimë nuk janë shqetësim vetëm për të gjallët, por ato fillojnë t’i vrasin për së dyti herë edhe të vdekurit.

Më tej, në tregimin “Funerali im”, autori ndërton ngjarje përmes së cilave trajton temat primordiale, atë të xhelozisë dhe të hipokrizisë. Në varrimin e narratorit-autor marrin pjesë edhe ata persona që e urrenin sa ishte gjallë, madje disa prej tyre edhe qanin, edhe pse ndoshta në thellësitë e tyre, këtë ditë e kishin pritur kaherë. Autori këtu spikat se njeriu më i mirë për njeriun, sot është njeriu i vdekur. Degradimin moral të njeriut si qenie, autori e përmend edhe te tregimi “Revolta e minjve”, në të cilin e vërteton teorinë, e cila duhet mbase të bëhet edhe ligj shkencor, në atë se njeriu shpeshherë është edhe më kafshëror sa edhe vetë kafsha.

Tema e patriotizmit të rremë, fenomen që po na shqetëson dita-ditës është preokupim i autorit në tregimin “Vrasësi i Titos”. Një njeri, që shquhej për njeri të ligë dhe gënjeshtar pandehte tek bashkëfshatarët malësorë se kishte vrarë Titon, udhëheqësin e atëhershëm jugosllav. Kjo i vjen në vesh pushtetit, dhe më pas e arrestojnë. Por, çfarë ndodhi më pas? Thuhej, se bëri marrëveshje me pushtetin që do dilte neper qytete dhe do të proklamonte ide nacionaliste, dhe në sytë e popullit do të paraqitej si atdhetar i paepur. Por, çfarë rezultati sillte kjo? Më pas arrestoheshin atdhetarët e vërtetë, të cilin binin pre e thirrjeve të rreme nacionaliste të tij.

Temën e luftës së fundit, por jo me topikë të një rajoni a zone të caktuar të Kosovës, autori do të trajtojë në disa tregime brenda kësaj përmbledhjeje. Ajo çka bie në sy është se nuk kemi as protagonistë e as antagonistë nga aradhet e UÇK-së, as himnizim e as përbuzje të luftës, por vetëm dhimbje. Në tregimin “Kthimi i babait” paraqitet episodi i kthimit të eshtrave të një shqiptari të vrarë në luftë. Në këtë tregim kemi rrëfim në vetën e dytë (teknikë e rrallë e përdorur në letërsinë shqipe, të cilin Olluri e përdor edhe në romanin “Bartësi i shpirtrave të përzënë”), ku i biri si narrator iu drejtohet me dhimbje, e tek tuk me nuanca krenarie eshtrave të babait, i cili u vra në luftë si ushtar i UÇK-së.

Në tetëmbëdhjetë tregimet, Olluri nuk mëton ta sulmojë religjionin por interpretimin e tij, jo pushtetin por pushtetarët e korruptuar, nuk sulmon patriotizmin por patriotët-folklorikë, jo luftën por përfituesit e saj. Në tetëmbëdhjetë tregime, Olluri fshikullon mbi padrejtësitë e të ligat që dita ditës e më shumë po na përdhosin të kaluarën, cenojnë të sotmen e po na vrasin të ardhmen.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Montimi Servisim Porosi
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Drita fiton derbi dhe merr kreun

Skuadrat nga qyteti i Gjilanit, Drita dhe Gjilani, pas dhjetë xhirove të zhvilluara janë duke dominuar në Superligë, pasi pikërisht këto dy skuadra pozicionohen të parat në tabelën e klasifikimit. Fitores i është rikthyer Prishtina, kurse Feronikeli vazhdon të mos jetë skuadër stabiliti në këtë edicion garash



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 20 tetor** - Skuadra e Dritës nga Gjilani të dielën e kësaj xhiro në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi e ka mposhtur Ballkanin (2-0). Ndeshja e zhvilluar në Gjilan ishte mjaft e tensionuar, me ç'rast u dhanë edhe dy karton të kuq. Vendësit e nisën më mirë ndeshjen dhe pas pesë minutave lojë kaluan në epërsi 1-0 me golin e Izair Eminit. Mysafirët u munduan të rikthehen në lojë, por aksioni i Krasniqit dhe Potokut përfundoi pa sukses. Në minutën e 24-t Drita i dha goditjen e dytë Ballkanit, duke shënuar për 2-0 nëpërmjet Gilberto Fortunatos. Në pjesën e dytë loja ishte më e ashpër dhe gjyqtari kryesor e ndëshkoi me karton të kuq Edmond Turkun e Ballkanit në minutën e 63-të. Dymbëdhjetë minuta më vonë me karton të kuq u ndëshkua edhe Liridon Leci. Rastin e fundit për skuadrën e Ismet Munishit e pati kapiteni Visar Berisha, por topi përfundoi në duart e portierit Darko Tofiloskit. Pas kësaj ndeshje Drita ngritët në pozitën e parë me 21 pikë, po aq sa ka edhe skuadra e Gjilanit. Ndërsa skuadra e Ballkanit mbetet në kuotën e 20 pikëve dhe renditet në pozitën e tretë. Pas barazimit ndaj Drenicës (0-0) në stadiumin "Fadil Vokrri", FC Prishtina u është rikthyer fitoreve në ndeshjen ndaj Ferizajt (0-2). Skuadra nga kryeqyteti arriti një trepikësh të madh nga përballja me skuadrën e Ferizajt, e cila vazhdon të ketë probleme të brendshme edhe në këtë edicion. Në minutën e 22-të Meriton Korenica e realizoi golin e parë për Prishtinën, kurse rezultatin final 0-2 e vulosi katër minuta para fundit të ndeshjes Ahmed Januzi. Rastet më të mira për vendësit i patën Dajaku dhe Livoreka, por nuk arritën ta mposhtin portierin Visar Bekaj. Pas kësaj ndeshje, Prishtina është e pesta me 17 pikë, kurse skuadra e Ferizajt është e nënta me 9 pikë. Në xhiron e radhës në stadiumin "Fadil Vokrri" takohen Prishtina dhe Drita. Fitore mjaft të rëndësishme që i mundësoi ngritjen në pozitën e dytë arriti edhe Gjilani. Kjo skuadër e mposhti Feronikelin në Drenas (1-2), kurse golat e fitores i realizuan Veliu dhe Kastrati, e për vendësit golin e vetëm e shënoi Jean Carioca. Fitore të rëndësishme ka realizuar edhe Llapi para tifozëve të vet në duel me Trepçën '89, me rezultat bindës 4-1. Dy gola për llapjanët i shënoi Labinot Osmani dhe nga një tjetër e shtuan Emini dhe Hyseni. Fitore me rezultat minimal ka shënuar edhe Dukagjini ndaj Vushtrrisë (1-0), kurse golin e vetëm për skuadrën nga Klina e realizoi Altin Merlaku në minutën e 17. Flamurtari dhe Drenica kanë luajtur baras në përballjen e zhvilluar në kryeqytet.

### Fiton Besa, mposhten Malisheva dhe Istogu

Besa e Pejës e ka fituar ndeshjen ndaj Onixit me rezultat 2-0. Skuadra pejane me tri pikët e reja ngritët në pozitën e dytë në Ligën e Parë me 17 pikë, tri pikë më pak se skuadra lidere, Liria, e cila në këtë xhiro barazoi me Ramiz Sadikun (2-2). Humbje të dielën kanë regjistruar edhe Malisheva në përballje me Ulpianën (0-3), sikurse edhe Istogu nga Vllaznia e Pozharanit (3-2).

**IPKO SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Drita - Ballkani | 2-0 |
| Ferizaj - Prishtina | 0-2 |
| Dukagjini - Vushtrria | 1-0 |
| Llapi - Trepça '89 | 4-1 |
| Feronikeli - Gjilani | 1-2 |
| Flamurtari - Drenica | 0-0 |

**TABELA**

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Drita | 10 | 21 |
| 2. Gjilani | 10 | 21 |
| 3. Llapi | 10 | 20 |
| 4. Ballkani | 10 | 20 |
| 5. Prishtina | 10 | 17 |
| 6. Feronikeli | 10 | 16 |
| 7. Drenica | 10 | 11 |
| 8. Trepça '89 | 10 | 10 |
| 9. Ferizaj | 10 | 9 |
| 10. Flamurtari | 10 | 9 |
| 11. Dukagjini | 10 | 7 |
| 12. Vushtrria | 10 | 6 |

**Në xhiron e radhës takohen: Vushtrria-Feronikeli, Trepça '89-Ferizaj, Gjilani-Llapi, Drenica-Dukagjini, Ballkani-Flamurtari, Prishtina-Drita.**

**LIGA E PARË**

| | |
|---|---|
| Vitia - Vëllaznimi | 5-2 |
| Ramiz Sadiku - Liria | 2-2 |
| Vllaznia - Istogu | 3-2 |
| Malisheva - Ulpiana | 0-3 |
| Dardana - Arbëria | 2-2 |
| 2 Korriku - Drenasi | 1-2 |
| Besa - Onix | 2-0 |

**Të hënën takohen:**
**KEK-u-Trepça**

**TABELA**

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Liria | 9 | 20 |
| 2. Besa | 9 | 17 |
| 3. Istogu | 9 | 17 |
| 4. Malisheva | 9 | 16 |
| 5. Drenasi | 9 | 15 |
| 6. Arbëria | 9 | 15 |
| 7. Trepça | 8 | 14 |
| 8. Dardana | 9 | 14 |
| 9. Vllaznia | 9 | 12 |
| 10. Ulpiana | 9 | 11 |
| 11. Onix | 9 | 10 |
| 12. Vitia | 9 | 9 |
| 13. Ramiz Sadiku | 9 | 8 |
| 14.2 Korriku | 9 | 7 |
| 15. KEK-u | 8 | 6 |
| 16. Vëllaznimi | 9 | 4 |

SHKURT

## KB Prishtina vazhdon të fitojë

Kampionia e Kosovës, Sigal Prishtina, ka vazhduar të fitojë në Superligë. Prishtinasit kanë mundur në udhëtim Lipjanin me rezultat 70:105 (11:27, 21:19, 18:28, 20:31). "Bardhekaltrit" kanë treguar një lojë më të mirë, duke qenë që nga fillimi në epërsi, derisa vetëm çereku i dytë ishte i barabartë. Te Lipjani u dalluan Demarkus Stuckey me 26 pikë, shtatë kërcime e shtatë asistime, si dhe Devaughn Jenkins me 23 pikë dhe dhjetë kërcime. Te Sigal Prishtina u dalluan Dardan Berisha me 29 pikë, pesë kërcime e pesë asistime dhe Fahro Alihoxhiq me 21 pikë, tetë kërcime e tri asistime. Prishtina ka katër fitore dhe një humbje, kurse kjo ishte humbja e gjashtë për Lipjanin nga gjashtë ndeshje.

## Fitojnë Prishtina, Kastrioti dhe Vushtrria

Prishtina ka fituar edhe ndeshjen e katërt rresht në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Prishtina fitoi ndaj Drenicës me rezultat 41:25. Prishtina që në pjesën e parë e ka bërë shkëputjen e madhe, duke fituar me 20:11. Beshiri me 12 gola dhe Bajqinovci me 11 ishin më efikasit për Prishtinën. Ndërsa Gashi realizoi 10 gola për Drenicën. Fitore shënuan edhe Kastrioti e Vushtrria. Kastrioti në Ferizaj e mposhti Vëllaznimin e Gjakovës me rezultat 26:25, ndonëse luajti pa shumicën e lojtarëve kryesorë. Për Kastriotin është fitorja e dytë nga tri ndeshje të luajtura. Vushtrria fitoi ndaj Llapit me rezultat 31:26. Vushtrria, po ashtu, shënoi fitoren e dytë, kurse është e treta në tabelë me 5 pikë.

## Salihi: Duhet t'i besojmë Rejas

Ish-sulmuesi i njohur i Kombëtares Shqiptare, tashmë ndihmës i trajnerit Edi Reja te kuqezinjtë, Hamdi Salihi, në emisionin "Zona Gol" të gazetarit Glendi Tafaj në Supersport ka thënë se trajnerit italian duhet t'i besohet për faktin se ka bërë një punë të mirë. "Unë ia kam thënë trajnerit, disa gjëra në fushë i shoh edhe si lojtar, edhe si trajner. Është një njeri që duhet t'i besohet, por në fund gjërat i vendos presidenti. Kam mendimin se ka bërë një punë të mirë, më shumë për qartësinë që lojtarët kanë në fushë. Është i thjeshtë dhe i qartë në gjërat që bën. Besoj se ajo që ka treguar ekipi në fushë i ka dhënë të drejtë trajnerit", ka thënë Salihu.

## Koemani dëshiron të bëhet trajner i Barçës

Ronald Koemanit në klauzolën e tij i lejohet që të kalojë te Barcelona edhe pse ka kontratë me kombëtaren e Holandës deri në vitin 2022. Trajneri holandez kishte bërë 264 paraqitje në gjashtë sezone të kaluara te blaugranasit si lojtarë. Ai fitoi dhjetë trofe të mëdhenj sa ishte te katalunasit, përfshirë këtu golin e shënuar ndaj Sampdorias në vitin 1992 në Kupën Evropiane në "Wembley". Holandezi gjithmonë ka bërë me dije se dëshiron të bëhet trajner i Barcelonës, mirëpo asnjëherë nuk ka pasur bisedime konkrete. Kampioni i La Ligës po mendon që ta shkarkojë Ernesto Valverden dhe Koeman shihet si kandidati kryesor.

## Marquezi konfirmohet kampion bote në Moto GP



